Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0101

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Astraplan SH.P.K." kundër anulimit të aktiviteti të prokurimit të Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i stacionit policor veri Prishtinë" me nr. të prokurimit: "214-22-10936-5-1-1", me 29/03/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Astraplan" Sh.P.K. me nr. 2024/101 , kurse vendimi i AK Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i stacionit policor veri Prishtinë" me nr. të prokurimit: "214-22-10936-5-1-1", anulohet dhe Aktiviteti i Prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe ndaj ZPP konform nenit 25 të LPP.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 14.10.2022, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i stacionit policor veri Prishtinë" me nr. të prokurimit: "214-22-10936-5-1-1". Ndërsa me datën 25.01.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku është anuluar akitiviteti i prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës **:** 1,538.842.70 Euro.

Me 29.01.2024, "Astraplan SH.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 01.02.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05.02.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Astraplan SH.P.K." me nr. 101/2024 për lidhur me aktivitetin "Ndertimi i stacionit policor veri Prishtinë" me nr. të prokurimit: "214-22-10936-5-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Astraplan SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I):Ankuesi pretendon se: "Neni 105 i LPP-së - Kompetencat e OSHP-së - Drejtori i zyrës se prokurimit pran AK-s, ka shkelur këtë nen dhe ka vepruar ne kundërshtim me vendimet e OSHP-s me nr. PSH. Nr. 373/2023, dhe OSHP: 2023/0762, me çka OSHP-ja do te duhej ne ditët ne vazhdim ti revokoj Certifikatën e prokurimit Artan Fejzes. OSHP-ja ka vërtetuar me dy(2) vendimet e saj se neve si OE jemi eliminuar kundërligjshëm dhe për kundër kësaj ZPP-Artan Fejza na eliminon përsëri. Në ankesë është i bashkangjitur një pjese nga gjetjet e PSH te vendimit OSHP: 2023/0762. Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi AK-ja ka bere diskriminimin e kompanisë tone pasi qe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat ne Dosjen e Tenderit dhe ne Njoftimin për Kontrate dhe kemi çmimin me te lire si OE me renditjen nr. 1 i përgjegjshëm. AK-ja ka qen e obliguar qe te analizoj kërkesën ne Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne DT dhe ne njoftim për kontratë, pasi qe ne rastin konkret te gjitha i kemi plotësuar. Ne dokumentin e dorëzuar me oferte ne platformën e e-prokurimit: I. (dokumenti me nr. 5.1 Lista E Stafit Te Inxhinierave Pjesa 1, dhe 5.2 Lista E Stafit Te Inxhinierave Pjesa 2), II. Ne këto dy dokumente janë te gjitha dëshmitë dhe se janë te gjitha te vërteta. Ke kërkesën nr. 2 te Neni 9.1 & 9.2 te DT-s ne pjesën e dëshmisë kërkohet (• Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin), prej nga manipulimi qe Ka kryer

Artan Fejza me listat e ATK-s dhe komunikimet ne ATK vetëm sa e vërteton ate qe kemi thëne deri me tani, se ju jeni duke vepruar nen ndikimin e interesit personal për te na dëmtuar neve si OE, për inatet tuja personale qe ke me neve,dhe ate ne kundërshtim me LPP-n dhe RRUOPP-n, vetëm e vetëm pse e keni pozitën dhe po mundeni te kryeni një shkelje te tillë. Te gjithë stafin qe e kemi prezantuar dhe qe nuk janë te punësuar me kontrata te rregullta i kemi bashkangjitur para kontratat (kontratat mbi vepër) kjo është e rregulluar shumë qartë edhe me Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve,- Nenit 33, par.1. Citat "Parakontrata është kontratë me të cilën merret përsipër detyrimi që më vonë të lidhet kontrata tjetër kryesore.", dhe kjo është treguesi me i mire se na ka diskriminuar ne mënyrën me te pa skrubullt për arsyet e me poshtme: Ne kemi deklaruar se i kemi bashkëpunëtor, e jo te punësuar. Këtë e vërteton edhe parakontrata qe është ne emër te projektit dhe vetëm për këtë projekt. Ne dosje te tenderit nuk është kërkuar qe stafi duhet te jetë i regjistruar ne ATK-para dorëzimit te tenderit, këtu keni manipuluar me dokumentet e tenderit.Fillimisht një oferte duhet te jetë e përgjegjshme administrativisht e pastaj te kalkulohen gabimet aritmetikore, nga kjo ju sqarojmë se me datën 06.12.2023 kemi pranuar-Letër standarde kërkesë për sqarimin e tenderit dhe me datën 07.12.2023 kemi dorëzuar Përgjigje ne Letër standarde kërkesë për sqarimin e tenderit, duke u bazuar ne përgjigjen qe kemi dhënë vërehet qarte se komisioni i vlerësimit e ka vlerësuar administrativisht ne rregull ofertën tone dhe ka kërkuar me datën 14.12.2023 -Letër standarde për sqarimin e tenderit llogaritje e gabuar, ku edhe kësaj ju kemi përgjigjur me 15.12.2023. Ne 3 ose 4 vlerësimet e komisionit brenda AK-s dhe 2 vendimet e OSHP-së (OSHP: 2023/0762 dhe OSHP: 2023/0373), kërkesat dhe arsyet e eliminimit janë vlerësuar plotësisht ne përputhje me kërkesat e DT dhe i kanë plotësuar kërkesat e DT-s dhe NJK, Neni 72 i LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Ju Artan Fejza keni vepruar ne kundërshtim me nenin 72, paragrafi 1; Citojmë paragrafin 1: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. AK-ja nuk ka pase te drejte e as nuk ja lejon LPP-ja qe te kërkoni sqarime jashtë atyre kërkesave qe janë vendosur ne DT-s dhe ne Njoftimin për Kontrate. Neni 56 i LPP-së- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave Kërkesat e AK-s janë një shkelje e rende e LPP-s dhe ne kundërshtim me nenin 56 paragrafi 3. citojmë (Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit), shkelje shume e rëndë Panelit Shqyrtues të OSHP-së ia prezantojë kërkesën e Autoritetit Kontraktues të përshkruar në Dosje të Tenderit dhe ne Njoftimin për Kontratë si më poshtë: Kërkesa 2-Lista e stafit profesion të operatorit konomik me përbërje si ne vijim : Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 5 vite pas diplomimit . Një (1) inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë dhe Arkitektur drejtimi Arkitektur (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 5 vite pas diplomimit. Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – Drejtimi Hidroteknik (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit . Një (1) Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit . Një (1) Inxhinier i diplomuar i Makineris (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit. Një (1) Gjeodet I diplomuar, i Licencuar (Inxhinier, master, apo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit. Dëshmi 2-Lista e stafit profesional duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe dëshmitë për secilin inxhinierë si ne vijim • Kontrata ose

para kontrata e punës valide me punëdhënësin. Diploma e inxhinierëve përkatës sipas lëmis së kërkuar e noterizuar, CV-it- e inxhinierëve. Referencat mbi përvojën e punë (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës), Për Gjeodet duhet te jetë edhe Licenca e punës valide. Siç shihet nga kërkesat e dosjes së tenderit rezulton se AK-ja, eliminimin tone nga gara ka bere shkelje flagrante te LPP-s dhe RRPP-s, në rastin konkret referuar nenit 52. par.3 të LPP-së citat" Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike" si dhe nenit 56. par.3 të LPP-së, citat" Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit", e po ashtu edhe ne kundërshtim me nenin 59 par.4. të LPP-së Nenit 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Autoriteti Kontraktues ka bere vlerësim te ofertave ne kundërshtim me nenin Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, dhe kjo është ne kundërshtim te plotë me nenin 59, paragrafin 4, citojmë paragrafin 4 te nenit 59 te LPP-s ("Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.) Po ashtu ne raportin e vlerësimit qe kemi marre ne qasjen për dokumente vërehet qarte dhe vërtetohet ajo qe kemi thënë se z. Fejza ka qen pjesëmarrës ne vlerësimin e ofertave ne kundërshtim me nenin neni 59 te LPP-s, nenin 39 dhe 40 te RRUOPP-s ose ne lidhje te ngushte ose i keni bere presion komisionit, sepse ne kërkesën për sqarime te nenit 9.1 dhe 9.1 te DT-s te datës 11.01.2024, Ne jemi përgjigjur me datën 15.01.2024 ne ora 12:18-12:20 minuta. JAk-ja ka komunikuar me ATK 15.01.2024 ne ora 09:32 minuta, d.m.th. pa e pranuar fare përgjigjën ne kërkesën për sqarime nga ana jonë. Ne raportin qe kemi pranuar nga qasja ne dokumente nuk janë te cekura fare kërkesat për sqarime te datës 06.12.2023, kjo len dyshime te mëdha se Artan Fejza ka manipuluar me letra dhe dokumente te tenderit. Këtu shihet dëshira qe ka pas për te shfrytëzuar çdo lidhje qe ke për te na shantazhuar. Në ankese është bashkangjitur një fotografi ne forme te dëshmisë. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, paragrafi 1: 1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. DMTH komisioni e ka ditur qe janë ne kundërshtim me kërkesat e DT-s dhe pikërisht për këtë arsye nuk ka kërkuar sqarim për këtë pike dhe nuk ka komunikuar me ATK-n. Këtu z. Artan Fejza ka shkelur neni 59 te LPP-s, nenin 39 dhe 40 te RRUOPP-s, pasi qe ka ndërhyrë ne vlerësim dhe ka ndikuar te komisioni, dëshmi shkresat qe ka komunikuar me komisionin dhe duke manipuluar kërkesat dhe shkresat ne kundërshtim me LPP-n, ka gënjyer duke i vu ne lajthitje komisionin për "dëshmi te rreme", ne fakt vet z. Arton Fejza ka dhënë dëshmi te rreme. Neni 69 i LPP-së- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale AK-ja ne kundërshtim me nenin 69 edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e nenit 9.1 dhe 9.2 te DT-s, nuk na ka rekomanduar për dhënie te kontratës edhe pasi qe neve si ose Astraplan ShPK na ka eliminuar edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat sipas Neni 9.1 & 9.2 te DT-s Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit 1. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo 2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e

nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve. D.m.th. asnjëra nga tri(3) kushtet e mësipërme nuk është plotësuar qe te anulohet tenderi."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Astraplan SH.P.K." konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 72, 52, 56, 59, 62, 69, 72, 105, të LPP-së si dhe neni 9.1 dhe 9.2 të DT-së. Pas përshkrimit të fakteve të lartshënuara dhe gjendjes faktike, pasi qe e plotësojmë kushtin tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët. nga paneli shqyrtues në OSHP kërkojmë që te merret: Vendim që të Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik Astraplan ShPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë, me nr. Prokurimit 214-22-10936-5-1-1. II. Anulohet njoftimi mbi Vendimin e AK-s Policia e Kosovës për dhënie te kontratës, si dhe aktiviteti i Prokurimit: Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë, me nr. Prokurimit 214-22-10936-5-1-1, kthehet ne Ri-Vleresim III. Të iniciohet revokimit i certifikatës profesionale të prokurimit ndaj z. Artan Fejza - zyrtar përgjegjës i prokurimit pran Policisë se Kosovës, konform 91.1 pika b) e Rregullores Nr.001/22 për Prokurimin Publik, dhe atë konform nenit 97 par.1, pika d), pika h), pika k) dhe pika o) të Rregullores Nr.001/22, sepse i njëjti ka bërë shkelje të rënda-"Recidivist" (te përsëritura) te LPP-s, siç specifikohet në nenin 97 të Rregullores Nr.001/22 për prokurim publik.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Pretendimi 1 lidhur me shkeljet e supozuara të Nenit 7të Ligjit të Prokurimit Publik refuzohet - Lidhur me supozimet që kanë të bëjnë me Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit, pasi që të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë aktivitet janë duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësit që i takojnë një Zyrtari përgjegjës të Prokurimit, të cilat janë të përcaktuara në LPP-në, dhe Rregulloren nr.001/2022 Udhëzimin nr. 001/2023 për Prokurim Publik, që do të ju informojmë si ne vijim: Bazuar në nenin 59 të LPP-së Autoriteti Kontraktues formon komision të vlerësimit të ofertave. Përgjegjësit dhe detyrat e Zyrtari përgjegjës i Prokurimit bazuar në nenin 11.1 Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik - Zyrtari përgjegjës i prokurimit (ZPP) është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK brenda kompetencave të tij dhe në pajtim me dispozitat e LPP. ZPP përveç obligimeve tjera ka përgjegjësitë në vijim: 1.. Rekomandon përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve 2. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shqyrton propozimin për kontratë të rekomanduar nga komisioni vlerësues 3.Pranon/refuzon rekomandimin e propozuar Gjithashtu bazuar në nenin 39.4 Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të organizoj punën e komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP. Bazuar në nenin 26 të LPP-së i zyrtari përgjegjës i prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidh ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues. Nënshkrimi dokumenton se kontrata është dhënë në pajtueshmëri me ligjin aktual. Dhe paragrafi 2 i nenit 26 të LPP-së Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Admmistrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik. Pretendimet e juaja dhe akuzat

ndaj zyrtarit përgjegjës të Prokurimit, janë të pa bazuar dhe konsiderohen si formë shantazhi për të krijuar frikë duke tentuar të ushtroni presion me qëllim të rekomandimit të kompanisë së juaj si fitues të këtij aktiviteti, të cilat janë iniciuar në organe tjera përgjegjëse për trajtim të më tutjeshëm.

Autoriteti kontraktues Policia e Kosove ka zbatuar nenin 7 të LPP-së dhe kemi trajtuar me kujdes në mënyre të barabarta dhe pa bërë diskriminim me ofertuesit tjerë, mirëpo dokumentacion i dorëzuar në ofertën e juaj ka pas diskrepancë dhe kundërthënie në mes veti. Autoriteti Kontraktues Polica e Kosovës Drejtoria e Prokurimit në harmoni me LPP-ne dhe Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik për të vazhduar më tutje me procesin e Ri-vlerësimit ka kërkuar sqarime shtesë pa paragjykuar ashtu siç keni cekur ju në këtë kërkesë duke u bazuar ne dokumentacionin e paraqitur ne ofertën datës 29.11.2022. Autoriteti kontraktues Polica e Kosove Drejtoria e Prokurimit ka kërkuar sqarime duke u bazuar ne LPP-ne Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë paragrafi 3: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Si dhe Rregulloren 001/2022 nenin Neni 38 Sqarimi i Tenderëve paragrafët: 38.1, 38.2, 38.3,38.4,38.5,38.6,38.8 duke kërkua informata shtesë për listën e stafit te paraqitur nga OE Astraplan SHPK e nënshkruar dhe vulosur ku janë te listuar emrat e personel Udhëheqës i kompanisë Astraplan SHPK për vitet 2019-2020-2021-2022. OE Astraplan SHPK e nënshkruar dhe vulosur ku janë te listuar emrat e personel Udhëheqës i kompanisë Astraplan SHPK për vitet 2019-2020-2021-2022. Sqarimet janë kërkuar për stafit profesional te prezantuar te Inxhinierëve, CV-te inxhiniereve, a janë të nënshkruara para kontratat dhe CV nga ky staf, deklarata me shkrim nga inxhinierët mbi para kontratat dhe CV e prezantuara ne oferte OE ASTRAPLAN SHPK, për të verifikuar të gjitha të dhënat a janë të vërteta. Në listën e stafit profesional të paraqitur në ofertën e datës 29.11.2022 nga OE Astraplan SHPK, e nënshkruar dhe vulosur, janë evidentuar emrat e stafit profesional - personeli që OE Astraplan SHPK i ka paraqitur si personelin udhëheqës të kompanisë për vitet 2019- 2020-2021-2022. Gjithashtu, në secilën CV të dorëzuar me ofertën në datën 29.11.2022, janë të evidentuar periudhat e punës të këtyre inxhinierëve në secilën CV të stafit profesional, të cilët kanë qenë të punësuar në kompaninë tuaj në vitet 2019,2020,2021,2022. Megjithatë, nuk keni dorëzuar referenca të lëshuara nga vetë kompania juaj (Astraplan SHPK), të cilat do të duhej të dëshmonin përvojën e punës në AstraPlan SHPK që nga viti 2019 deri në 2022, ashtu siç është paraqitur në dokumentacionin bashkangjitur me ofertën. 1. CV e inxhinierit Bedri Asllani: Në faqen e parë të CV-së, është paraqitur periudha e punës në "Astraplan SHPK" nga viti 2021. Pozita e mbajtur në kompani është Inxhinier i Diplomuar në Arkitekturë. Gjithashtu nga sqarimet e bëra, është prezantuar deklarata të këtij inxhinieri që ka potencuar që të gjitha të dhënat në CV janë të vërteta. Mirëpo nga sqarimet e pranuara nga ATK-ja (Administrata Tatimore e Kosovës) nuk ka qenë asnjëherë i punësuar në kompaninë e juaj. Fakt tjetër është edhe vetë potencimi në Kërkesën për Rishqyrtim të dorëzuar nga ju në pretendimin e parë pika 3 keni potencuar që i gjithë stafi i prezantuar nuk janë të punësuar në kompaninë e juaj mirëpo kanë kontratë bashkëpunimi vetëm për këtë projekt. Kërkesa për Rishqyrtim e ka faktuar edhe më tepër që ju keni dorëzuar dokumentacion të rrejshëm për këtë inxhinier. 2.Të bashkëngjitura janë CV dhe deklaratë inxhinierit. CV e inxhinierit Xhemsir Mulliqi: Në faqen e parë të CV-së, është paraqitur periudha e punës në "Astraplan SHPK" nga viti 2020. Pozita e mbajtur në kompani është Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë. Gjithashtu nga sqarimet e bëra, është prezantuar deklarata të këtij inxhinieri që ka potencuar që të gjitha të dhënat në CV janë të vërteta. Mirëpo nga sqarimet e pranuara nga ATK-ja (Administrata Tatimore e Kosovës) nuk ka qenë asnjëherë i punësuar në kompaninë e juaj. Fakt tjetër është edhe vetë potencomi në Kërkesën për Rishqyrtim të dorëzuar nga ju në

pretendimin e parë pika 3 keni potencuar që i gjithë stafi i prezantuar nuk janë të punësuar në kompaninë e juaj mirëpo kanë kontratë bashkëpunimi vetëm për këtë projekt. Kërkesa për Rishqyrtim e ka faktuar edhe më tepër që ju keni dorëzuar dokumentacion të rrejshëm për këtë inxhinier. Në vazhdimi ju bashkëngjisim CV dhe deklaratë inxhinierit. 3.CV e inxhinierit Skender Cakaj: Në faqen e parë të CV-së, është paraqitur periudha e punës në "Astraplan SHPK" nga viti 2021 Current (vazhdon). Pozita e mbajtur në kompani është Inxhinier i diplomuar i Hidroteknikës. Gjithashtu nga sqarimet e bëra, është prezantuar deklaratë të këtij inxhinieri që ka potencuar që të gjitha të dhënat në CV janë të vërteta. Mirëpo nga sqarimet e pranuara nga ATK-ja (Administrata Tatimore e Kosovës) nuk ka qenë asnjëherë i punësuar në kompaninë e juaj. Fakt tjetër është edhe vetë potencomi në Kërkesën për Rishqyrtim të dorëzuar nga ju në pretendimin e parë pika 3 keni potencuar që i gjithë stafi i prezantuar nuk janë të punësuar në kompaninë e juaj mirëpo kanë kontratë bashkëpunimi vetëm për këtë projekt. Kërkesa për Rishqyrtim e ka faktuar edhe më tepër që ju keni dorëzuar dokumentacion të rrejshëm për këtë inxhinier . Në vazhdimi ju bashkëngjisim CV dhe deklaratë inxhinierit:4. CV e inxhinierit Sabri Zeqiri: Në faqen e parë të CV-së, është paraqitur periudha e punës në "Astraplan Shpk" nga 1/2021. Pozita e mbajtur në kompani është Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës. Gjithashtu nga sqarimet e bëra, është prezantuar deklaratë të këtij inxhinieri që ka potencuar që të gjitha të dhënat në CV janë të vërteta. Mirëpo nga sqarimet e pranuara nga ATK-ja (Administrata Tatimore e Kosovës) ka qenë i punësuar vetëm 2 muaj (nëntor dhjetor 2022) në kompaninë tuaj. Fakt tjetër është edhe vetë potenconi në Kërkesën për Rishqyrtim të dorëzuar nga ju në pretendimin e parë pika 3 keni potencuar që i gjithë stafi i prezantuar nuk janë të punësuar në kompaninë e juaj mirëpo kanë kontratë bashkëpunimi vetëm për këtë projekt. Kërkesa për Rishqyrtim e ka faktuar edhe më tepër që ju keni dorëzuar dokumentacion të rrejshëm për këtë inxhinier. Në vazhdimi ju bashkëngjisim CV dhe deklaratë inxhinierit. 4.CV e inxhinierit Muharrem Musliu: Në faqen e parë të CV-së, është paraqitur periudha e punësnë "Astraplan Shpk" nga viti 2021 Pozita e mbajtur nëkompani është Inxhinier i diplomuar i Makinerisë. Gjithashtu nga sqarimet e bëra, është prezantuar deklaratë të këtij inxhinieri që ka potencuar që të gjitha të dhënat në CV janë të vërteta. Mirëpo nga sqarimet e pranuara nga ATK-ja (Administrata Tatimore e Kosovës) nuk ka qenë asnjëherë i punësuar në kompaninë e juaj. Fakt tjetër është edhe vetë potenconi në Kërkesën për Rishqyrtim të dorëzuar nga ju në pretendimin e parë pika 3 keni potencuar që i gjithë stafi i prezantuar nuk janë të punësuar në kompaninë e juaj mirëpo kanë kontratë bashkëpunimi vetëm për këtë projekt. Kërkesa për Rishqyrtim e ka faktuar edhe më tepër që ju keni dorëzuar dokumentacion të rrejshëm për këtë inxhinier. Në vazhdimi ju bashkëngjisim CV dhe deklaratën e inxhinierit. 5. CV e inxhinierit Arban Grajçevci: Në faqen e parë të CV-së, është paraqitur periudha e punës në "Astraplan Shpk" nga 20/11/2019 Current (vazhdon) Pozita e mbajtur në kompani është Gjeodeti. Gjithashtu nga sqarimet e bëra, është prezantuar deklaratë të këtij inxhinieri që ka potencuar që të gjitha të dhënat në CV janë të vërteta. Mirëpo nga sqarimet e pranuara nga ATK-ja (Administrata Tatimore e Kosovës) nuk ka qenë asnjëherë i punësuar në kompaninë e juaj. Fakt tjetër është edhe vetë potenconi në Kërkesën për Rishqyrtim të dorëzuar nga ju në pretendimin e parë pika 3 keni potencuar që i gjithë stafi i prezantuar nuk janë të punësuar në kompaninë e juaj mirëpo kanë kontratë bashkëpunimi vetëm për këtë projekt. Kërkesa për Rishqyrtim e ka faktuar edhe më tepër që ju keni dorëzuar dokumentacion të rrejshëm për këtë inxhinier. Në vazhdimi ju bashkëngjisim CV dhe deklaratë inxhinierit. Pretendimi 2 lidhur me shkeljet e supozuara të Nenit 72 të Ligjit të Prokurimit Publik refuzohet. Ne si AK konkretisht kemi zbatuar nenin 72 të LPP-së dhe nuk jeni eliminuar pa kërkuar sqarime shtesë për të dhënat që kanë qenë në dëshmitë dokumentare të dorëzuar ne ofertën OE Astraplan ShPK. Përpos që kemi kërkuar sqarime nga ana e juaj si OE, kemi kërkuar sqarime nga Institucione përkatës të Republikës së Kosovës për të vërtetuar të dhënat dhe

dëshmitë dokumentare të dorëzuar nga ana e juaj. Ju jeni përgjigjur sqarimeve të kërkuara, të cilat kanë vërtetuar që dokumentacioni i dorëzuar më ofertë është i rrejshëm, të vërtetuar edhe nga sqarimet e bëra nga ATK-ja, qe te dhënat e listuar me emrat e personel Udhëheqës i kompanisë Astraplan ShPK për vitet 2019-2020-2021-2022 dhe te dhënat në CV të inxhinierëve qe kanë te paraqitur punëdhënës ASTRAPLAN SHPK PK dhe ketë e dëshmon ATK me njoftimin zyrtar te datës 17.01.2024 qe nuk jeni tatim pagues ashtu siç janë te dëshmuara ne dokumente te ofertës dhe sqarimet, deklarata nga stafi qe ju jeni punëdhënës dhe nuk janë te paraqitur ne ATK nga OE Astraplan Shpk, si punëdhënës dhe sqarimet qe keni ofruar nuk janë reale me deklarimet e juaja dhe këto janë ne kundërshtim me Deklaratën nën Betim te datës 29.11.2022 nga ana juaj. Pretendimi 3 lidhur me shkeljet e supozuara të Nenit 105 të Ligjit të Prokurimit Publik refuzohet - pasi që nuk është sqaruar nga OE se për cilat kërkesa është fjala që ne nuk kemi respektuar 2 vendimet e PSH të OSHP-së. Autoriteti Kontraktues ka zbatuar dhe respektuar dy vendimet e PSH OSHP-së dhe për të gjitha pretendimet të cilat janë gjykuar nuk jeni eliminuar, mirëpo jeni eliminuar nga komisioni i ri rivlerësues për dokumentacion të cilin keni dorëzuar jo në përputhje me Deklaratën nën Betim për të cilat keni ofruar arsye që kanë qenë në kundërthënie në mes vete . Pretendimi 4 lidhur me shkeljet e supozuara të Nenit 56 të Ligjit të Prokurimit Publik refuzohet pasi që ju jeni diskualifikuar për dokumentacion të cilin kanë qenë kërkesë në DT, për të cilat keni dorëzuar dëshmi dokumentare në kundërshtim më Deklaratën nën Betim, më evidentimet të pa mbështetur me dokumentacion sqarues sipas listës se stafit te prezantuar si staf profesional për projektet e OE ASTRAPLAN SHPK për vitet 2019-2020-2021-2022 si dhe për CV-të e inxhinierëve, kemi të bëjmë me dëshmi dokumentare të dorëzuar me evidentime të rrejshme apo kemi të bëjmë me OE që mund të jeni delikuent (shkelës) i pagesave të tatimeve dhe kontributeve të Punëtorëve. Pretendimi 5 lidhur me shkeljet e supozuara të Nenit 59 të Ligjit të Prokurimit Publik refuzohet pasi që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-së. Sa i përket pretendimit që ne kemi qenë pjesëmarrës në ri vlerësim nuk qëndron për arsye që ri vlerësimin e ofertave e ka bërë komisioni ri vlerësues dhe udhëheqësi i prokurimit ka zbatuar detyrat dhe përgjegjësit që i takojnë. Lidhur me kërkesën për sqarime që janë bërë nga Autoriteti Kontraktues të ATK-ja pak kohë para dorëzimit të sqarimeve nga vetë OE, është një argument i fortë që Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur asnjë indikacion apo tendencë, përpos dëshirën për ekzaminimi, vlerësim dhe krahasim duke vërtetuar në mënyre të paanshëm dokumentacionin e dorëzuar me ofertë, dhe në rast që ne si AK do të kërkonim sqarime nga ATK-ja pas dorëzimit të sqarimeve nga ana e juaj, ndoshta do të mund të supozonit se ne pas sqarimeve të juaja kemi kërkuar edhe nga ATK-ja. Pretendimi 6 lidhur me shkeljet e supozuara të Nenit 69 të Ligjit të Prokurimit Publik refuzohet - Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Dhe AK ka kërkuar nga OE sqarime që të sigurohet se a janë të sakta ato te cilat OE i ka prezantuar në CV. Me qenë se ju keni prezantuar të dhëna në dokumentacionin për të plotësuar kërkesat e Aftësisë Teknike dhe/ose Profesionale me të dhëna të pa qëndrueshme, për të cilat nuk keni dhënë dëshmi të mjaftueshme as në sqarime e as nuk janë përputhur me të dhënat e siguruar nga ATK-ja, përpos që kanë rezultuar që ju keni paraqitur të dhëna të rrejshme në CV-it e inxhinierëve. Pretendimi 7 lidhur me shkeljet e supozuara të Nenit 62 të Ligjit të Prokurimit Publik refuzohet pasi që Anulimi i procedurës është bërë në përputhje të plotë me neni 43 të Rregullores nr.001/2022 të Prokurimit Publik paragrafi 5 citoj: 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; Sa i përket konstatimit të juaj PS citoj „ E keni harruar kamionin ma ne fund, dhe kur ju kanë mbylle të gjitha rrugët edhe është dashtë të na rekomandojnë për kontratë komisioni keni ndërhy ne vlerësim, gjë qe e

kemi prit se ju njohim"- Besojmë që ky potencim nuk ka të bëjë me kërcënim ndaj ZPP-së mirëpo besojmë që ka të bëjë me mos njohuri lidhur me shkresa apo kërkesa për rishqyrtim, që nga kërkesa për Rishqyrtim dërgohen mesazhe të tilla direket ndaj ZPP-se. Si do që të jetë apo në çfarëdo forme që keni dërguar, të gjitha shkresat e juaja dhe AK janë proceduar për tu trajtuar nga organet tjera kompetente, dhe bazuar në tekstin e shkruar, sqarojmë që lidhur me kamionin e potencuar për të cilin komisioni i me hershme Ri vlerësues ka pasur dyshime dhe për të cilën është konstatuar nga PSH i OSHP-së që kjo kërkesë është në përputhje me DT, ne si AK kemi respektuar vendimin e PSH të OSHP-së një argument shtesë për të demantuar pretendimet e juaja që nuk kemi respektuar vendimet e OSHP-së. Andaj të gjitha pretendimet janë të pabazuar dhe të gjitha pretendimet janë të refuzuar, pasi që kemi të bëjmë më dokumentacion me përmbajtje të cilat OE ASTRAPLAN SHPK nuk ka arrit të argumentoj, dhe të cilat konsiderohen që janë të manipuluar, të rrejshme, apo fiktive."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 13.02.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 101/2024, ndërsa me datë 27.02.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/101 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Nuk Pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa OE ka deklaruar se Pajtohet me mendimin e eksperteve.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Astraplan SH.P.K."- eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/101 kanë vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës: Për këtë aktivitet të prokurimit, i njëjti OE ankues parashtron ankesë për herë të tretë, ku në dy rastet paraprake përmes vendimeve 373/23 dhe 762/23 ankesa e OE është aprovuar si e bazuar dhe lënda është kthyer në rivlerësim. Përmes vendimit 762/23 në arsyetim të këtij vendimi OSHP ka konstatuar se pala ankimore (OE ankues Astraplan) është e

përgjegjshme.

Konstatimi i Ekspertit Shqyrtues : “Sa i perket pretendimeve ankimore ne ankesen 101/24 dhe arsyes se eliminimit te OE ankues, japim sqarimet si ne vijim. Dokumentet nga ATK te kërkuara nga Autoriteti Kontraktues si “sqarime” nuk kanë qenë kërkesë në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit, andaj përdorimi i tyre për vlerësim dhe eliminim të operatorit ekonomik sipas mendimit tonë është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 7 të LPP-së, par.6, pika (v). Sipas nenit 72 të LPP-së, kërkesa AK-së bëhet për sigurimin e informacionit “që mungon”, ose informacioni apo dokumentacioni qe duket të jetë jo i plot ose i gabuar. Në rastin konkret dëshmia e ATK-s nuk ka qenë fare kërkesë e dosjes, andaj nuk ka si të jetë “informacion që mungon”, e rrjedhimisht as informacion jo i plotë ose i gabuar, andaj mendimi jonë është se kërkesa e AK është në kundërshtim edhe me nenin 72 par.1, par.2 dhe par.3 të LPP-së Përmes ankesës OE : Astrpaln sh.p.k, i njëjti sqaron se i ka ofruar sqarimet/konfirmimet për vërtetësinë e nënshkrimit dhe deklaratën për të dhënat në CV të personave të apostrofuar, ndërsa për të njëjtit persona nuk mund ofrojnë pagesën e kontributeve nga ATK pasi të njëjtit kanë qenë të angazhuar me parakontrata. OSHP përmes vendimit 762/23 për të njëjtin aktivitet të prokurimit shprehimisht ka konstatuar se OE (atëherë OE ankues) është palë ankimore e përgjegjshme.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i stacionit policor veri Prishtinë” me nr. të prokurimit: “214-22-10936-5-1-1”. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues“Astraplan SH.P.K. dhe se, argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, përshkak se këto konstatime janë ta bazuara në dispozita ligjore. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Astraplan SH.P.K. janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit

shqyrtues ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar, për shkak se OE ankues është eleminuar për kërkesa të cilat nuk kanë qenë në Njoftim për Kontrat dhe Dosje të Tenderit siç është dëshmia nga ATK, e për më tepër për inxhinier të cilët janë të angazhuar me parakontrata, e në rastin konkret Paneli Shqyrtues vlerëson se kjo është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP, i cili citon: "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata,* ***nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit***".

Po ashtu, Paneli Shqyrtues thekson se ky aktivitet i prokurimit është iniciuar në vitin 2022 dhe është ankesa e 5 (pestë) me radhë për të cilat OSHP ka nxjerrë vendim, dhe për të gjitha këto ankesa OSHP ka nxjerë vendime duke u bazuar gjithmon në dispozita ligjore dhe konform rekomandimeve të ekspertëve shqyrtues përfshirë edhe ekspert teknik. Vendimet paraprake të PSH Nr. 2023/0356, 2023/0373, 2023/ 0389, 2023/0762 si dhe përfshirë tani edhe këtë vendim. Prolongimi i deritanishëm i këtij aktiviteti të prokurimit në bazë të konstatimeve të Ekspertëve Shqyrtues dhe konstatimeve të Paneleve Shqyrtuese, ka ardhur si rezultat i shkeljeve të vazhdueshme të bëra nga ana e autoritetit kontraktues. Kështu që, këto veprime të AK nuk mund të shihen ndryshme pos si veprime tendencioze dhe në dëm të operatorëve ekonomik dhe vet institucionit, duke mos i vlerësuar ofertat konform nenit 59 dhe 60 të LPP.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i stacionit policor veri Prishtinë" me nr. të prokurimit: "214-22-10936-5-1-1", të anulohet vendimi i AK dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës , ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit "Ndërtimi i stacionit policor veri Prishtinë" me nr. të prokurimit: "214-22-10936-5-1-1". të kthehet në rivlerësim si dhe AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **Astraplan SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: